



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KËSHILLI DREJTUES

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Datë \_\_\_\_ .12. 2018

**VENDIM**

**Nr.100, datë 24.12.2018**

**PËR**

**“MIRATIMIN E STRATEGJISË DHE PLANIT TË VEPRIMIT TË AKEP PËR VITIN 2019”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

1. Z. Ilir	Zela	Kryetar
2. Znj Edlira	Dvorani	Anëtar
4. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.Ina Nuellari, në mbledhjen e datës 24.12.2018, sipasa procedurës së përcaktuar në Ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregullores së Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues, shqyrtoi çështjen me objekt:

- “Miratimi Strategjisë dhe Planit të Veprimit të AKEP për vitin 2019”

**BAZA LIGJORE:**

1. Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
2. Ligji nr. 46/2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 46/2015**).
3. Rregullore e Brendshme për Funksionimin e Këshillit Drejtues (KD) të AKEP, miratuar me Vendim të KD Nr.7, datë 16. 02.2017;
4. Rregullore e Brendshme e Funksionimit të Administratës së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), miratuar me Vendim të KD Nr.6, datë 16. 02.2017, e ndryshuar;

## KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Strategjia dhe Plani i Veprimit të AKEP për vitin 2019 (*Dokumenti*);
2. Relacionin shpjegues mbi Dokumentin (*Relacioni*);
3. Projekt-Aktin vendimmarrës të Këshillit Drejtues(*Projektvendimi*);

si dhe nga konsiderimi i shpjegimeve të dhëna nga relatori i çështjes dhe diskutimeve në mbledhje;

### V Ë R E N:

1. AKEP është organi rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar, i cili mbikqyr kuadrin rregullator të përcaktuar nga ligji për komunikimet elektronike, nga ligji për shërbimin postar dhe nga politikat e zhvillimit, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave. Në kuadër të objektivave të përcaktuara rregullatore, AKEP duhet të planifikojë programin e tij të ardhshëm të aktiviteteve në përgjigje të nevojave të tregut, duke marrë parasysh prioritetet kryesore.
2. Dokumenti “Strategjia dhe Plani i Veprimit të AKEP për Vitin 2019” i paraqitur nga Kryetari i Këshillit Drejtues përmban fushat kryesore dhe prioritetet strategjike ku do fokusohet puna e AKEP gjatë vitit 2019. AKEP do të punojë që gjatë vitit 2019 të ketë progres në katër fusha kryesore nëpërmjet prioriteteve strategjike të identifikuara për secilën fushë dhe masat specifike për realizimin e tyre, pra Planin e Veprimit të AKEP për vitin 2019.
3. Ky dokument është përgatitur pas seminarit “Strategjia dhe plani i veprimit të AKEP për vitin 2019”, të organizuar nga AKEP në Vlorë më datë 10-11.12.2018, me pjesëmarrjen e punonjësve të AKEP dhe përfaqësues nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti i Konkurrencës, Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, operatorët kryesorë të komunikimeve elektronike në Shqipëri si dhe ekspertë të fushës.
4. Dokumenti konsideron plotësisht sa përcaktohet në pikën 2 të nenit 30 të Rregullore e Brendshme e Funkcionimit të Administratës së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), si dhe konkluzionet e arritura në Seminarin me temë “Strategjia dhe Plani i Veprimit të AKEP për vitin 2019” zhvilluar në Vlorë datë 10-11.12.2018.

### P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 114 të ligjit nr. 9918, ligjit nr. 46/2015 dhe nenit 19 të Rregullore e Brendshme për Funkcionimin e Këshillit Drejtues (KD) të AKEP, miratuar me Vendim të KD Nr.7, datë 16. 02.2017.

### V E N D O S:

1. Miratimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit të AKEP për vitin 2019 sipas dokumentit bashkëlidhur.

2. Vendimi dhe dokumenti “Strategjia dhe Plani i Veprimit të AKEP për vitin 2019” të publikohen në faqen online të AKEP [www.akep.al](http://www.akep.al).
3. Ngarkohet Kabineti dhe gjithë strukturat e AKEP për zbatimin e këtij vendimi dhe Strategjisë dhe Planit të Veprimit për vitin 2019.

Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

**Kryetar**

**Anëtar**

**Anëtar**

**Anëtar**

**Ilir ZELA**

**Klarina ALLUSHI**

**Ketrin TOPÇIU**

**Edlira DVORANI**



**“STRATEGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT  
TË AKEP PËR VITIN 2019”**

*(Miratuar me VKD nr.100, datë 24.12.2018)*

## INDEKSI I PERMBAJTJES

I.	HYRJE .....	3
II.	FUSHAT KRYESORE, PRIORITETET STRATEGJIKE DHE VEPRIMET SPECIFIKE.....	5
	II.1 FUSHAT KRYESORE DHE PRIORITETET STRATEGJIKE .....	5
	II.2 VEPRIMET SPECIFIKE.....	7
	ANEKS 1: PLANI I VEPRIMIT TË AKEP PËR VITIN 2019.....	22

## I. HYRJE

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) është organi rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar, i cili mbikqyr kuadrin rregullator të përcaktuar nga ligji për komunikimet elektronike, nga ligji për shërbimin postar dhe nga politikat e zhvillimit, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave. Roli, funksionet dhe kompetencat institucionale si organ rregullator i fushës së komunikimeve elektronike dhe shërbimit postar përcaktohen në legjislacionin material për komunikimet elektronike dhe shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë:

- Ligji Nr. 9918/2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe
- Ligji Nr. 46/2015, “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”.

Në kuadër të objektivave rregullatore, AKEP duhet të planifikojë programin e tij të ardhshëm të aktiviteteve në përgjigje të nevojave të tregut, duke marrë parasysh prioritetet kryesore strategjike.

Qëllimi i këtij dokumenti është që AKEP të përcaktojë fushat kryesore dhe prioritetet strategjike për vitin 2018 si dhe veprimet që do ndërmerren nga AKEP gjatë vitit 2019 për të përmbushur objektivat rregullatore të përcaktuara në legjislacionin për komunikimet elektronike dhe shërbimet postare si dhe në politikat dhe strategjitë përkatëse sektoriale të qeverisë.

Dokumenti u përgatit pas seminarit “*Strategjia dhe plani i veprimit të AKEP për vitin 2019*”, të organizuar nga AKEP në Vlorë më datë 10-11 Dhjetor 2018, me pjesëmarrjen e punonjësve të AKEP dhe përfaqësues nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti i Konkurrencës, Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, operatorët kryesorë të komunikimeve elektronike në Shqipëri si dhe ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të sektorit. Qëllimi i seminarit ishte që AKEP të prezantonte rezultatet e punës për përmbushjen e “*Strategjisë dhe planit të veprimit të AKEP për vitin 2018*”, si dhe të identifikonte prioritetet kryesore strategjike dhe veprimet specifike për t’u ndërmarrë nga AKEP për vitin 2019, me qëllim përmbushjen e objektivave rregullatore të përcaktuara nga ligji dhe politikat dhe strategjitë e sektorit të qeverisë.

Ky dokument përmban fushat kryesore dhe prioritetet strategjike ku do fokusohet puna e AKEP gjatë vitit 2019, duke marrë në konsideratë punën e kryer gjatë vitit 2018. AKEP do të punojë që gjatë vitit 2019 të ketë progres në katër fusha kryesore nëpërmjet prioritetëve strategjike të

identifikuara për secilën fushë dhe masat specifike për realizimin e tyre, pra Planin e Veprimit të AKEP për vitin 2019.

Në Kapitullin II, dokumenti përmban fushat kryesore dhe prioritetet strategjike të identifikuara për punën e AKEP për vitin 2019 dhe për një periudhë afat-mesme, si dhe përshkrimin e detajuar të veprimeve specifike sipas prioriteteve strategjike. Fushat kryesore, prioritetet strategjike, veprimet specifike të tyre janë përmbledhur në mënyrë tabelare në Aneks 1 të këtij dokumenti.

## II. FUSHAT KRYESORE, PRIORITETET STRATEGJIKE DHE VEPRIMET SPECIFIKE

### II.1 Fushat Kryesore dhe Prioritetet Strategjike

Bazuar në ecurinë e sektorëve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve postare, problematikës së evidentuar në këto sektorë si dhe me qëllim përmbushjen e objektivave rregullatore të përcaktuara në ligjet organike për komunikimet elektronike dhe shërbimet postare si dhe në politikat dhe strategjitë përkatëse sektoriale të qeverisë, AKEP ka evidentuar katër fusha kyce ku duhet të fokusojë punën e tij gjatë vitit 2019:

1. Kushte të favorshme për Investitorët
2. Nxitje e konkurrencës
3. Mbrojtje e konsumatorit
4. Efikasitet i brendshëm i AKEP dhe bashkëpunimi me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Për secilën prej fushave të mësipërme AKEP ka evidentuar prioritetet strategjike dhe veprimet specifike që do të ndërmerren gjatë vitit 2019 për të bërë progres në secilën prej fushave kryesore. Skema e mëposhtme përmban fushat kryesore dhe prioritetet strategjike për vitin 2019, ndërsa përshkrimi i prioritetëve si dhe veprimeve specifike që do të ndërmerren nga AKEP për vitin 2019 dhe në disa raste për një periudhë afat-mesme janë dhënë në seksionin 2 të këtij kapitulli.



## Skema 1: Fushat Kryesore dhe Prioritetet Strategjike të Punës së AKEP për vitin 2019.

### 1. Kushte të favorshme për Investitorët

- Rregulla të qarta dhe të qëndrueshme në kohë për zhvillimin e hapur të infrastrukturës broadband.
- Nxitja e investimeve në infrastrukturen me Fiber Optike.
- Përsheptimi i procedurave për vendien në dispozicion të operatoreve të spektit të pershtatshëm për shërbimet broadband.
- Mbeshtetja e iniciativave për zhvillim broadband në zonat komercialisht jo-tërheqëse.
- Nxitja e sigurisë së rrjeteve dhe informacionit në linjë me rregullat e BE për sigurinë kibernetike

### 2. Nxitje e konkurrencës

- Kryerja e analizave të tregut dhe vendosja e masave rregullatore për operatorët me FNT.
- Orientimi në kosto i tarifave të operatorëve me FNT dhe identifikim i sjelljeve antikonkurrese
- Monitorim/Vlerësim i tregjeve të shërbimeve postare.
- Përmirësimi i cilësisë së të dhënave të dorëzuara nga operatorët dhe raporteve të AKEP për statistikat.

### 3. Mbrojtje e konsumatorit

- Rishikimi i kuarit rregullatore për mbrojtjen e konsumatorit/përdoruesit
- Përmirësimi i informacionit për konsumatorin
- Implementimi i marrëveshjeve RLAH me Kosoën dhe vendet e Ballkanit Perëndimor
- Monitorimi i mbulimit me rrjet dhe QoS në zonat me dendësi të ulët popullore.
- Masa për Net-Neutrality
- Garantimi i SHU postar dhe cilësia e shërbimeve postare
- Masa për ofrimin e SHU të komunikimeve elektronike

### 4. Efikasiteti i brendshëm AKEP dhe partneritetet me institucionet

- Garantimi i funksionimit ligjor dhe institucional të AKEP. Vlerësim i nevojës për amendime të legjislacionit.
- Përmirësim në forcimin e kapaciteteve dhe efikasitetit të brendshëm të AKEP.
- Bashkëpunim i ngushtë dhe arritje e koherencës së plotë me rregullatorin ex-post, AK dhe Komisionin e Mbrojtjes së Konsumatorit
- Projekti për zbatimin e Qendrës Kombëtare të Radio Frekuencave.

## II.2 Veprimet specifike

Ky seksion përmban një përshkrim të prioriteteve strategjike dhe veprimeve specifike që do të ndërmerren nga AKEP gjatë vitit 2019, sipas fushave përkatëse kryesore.

### Fusha 1: Kushte të favorshme për investitorët

#### 1.1. Rregulla të qarta dhe të qëndrueshme për zhvillimin e infrastruktures së broadband

##### 1.1.1. Mbështetje dhe bashkëpunim me MIE në përgatitjen dhe implementimin e legjislacionit sekondar për Ligjin Nr.120/2016.

Ligji nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit”, miratuar më datë 24 Nëntor 2016, ka për qëllim të lehtësojë dhe promovojë ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike. Ky ligj rregullon aksesin në infrastrukturën e operatorëve të rrjeteve të sektorëve në industri të tjera, i cili mund të përdoret për rrjetet e komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë.

Gjatë vitit 2018, AKEP ka bashkëpunuar ngushtë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe operatorët e komunikimeve elektronike në përgatitjen e legjislacionit sekondar implementues të parashikuar në këtë ligj. MIE ka kryer procese këshillimi publik dhe takime me palët kryesore të interesuara gjatë vitit 2018 për projekt-Vendimet e Këshillit të Ministrave për Ligjin 120/2016 dhe AKEP do të vijojë të asistojë MIE dhe palët e tjera të interesuara në këtë proces.

Për të lehtësuar zbatimin e rregullave të reja që pritet të miratohen, AKEP do të ndërmarrë hapa të mëtejshëm për ngritjen e një grupi pune me përfaqësues të investitorëve kryesorë në sektorin e komunikimeve elektronike dhe sektorë të tjerë të lidhur, për të promovuar përdorimin e përbashkët të infrastrukturës, investimet e përbashkëta në rrjete dhe koordinimin e punëve civile, si dhe aksesin në rrjetin e brendshëm të ndërtesave.

##### 1.1.2. Masa rregullatore proporcionale për tregjet me shumicë broadband për të mbrojtur dhe promovuar stimujt e investimeve për broadband

AKEP gjatë vitin 2019 do të kryejë analizën e re të tregut për tregjet me shumicë broadband (tregjet 3 dhe 4 të Rekomandimit të KE 2014 për tregjet përkatëse,) ku synon të përmirësojë detyrimet rregullatore për operatorin/operatorët që aktualisht janë me FNT, për të nxitur më tej konkurrencën në infrastrukturë, përdorimin e përbashkët të infrastrukturës aktuale si dhe njëkohësisht për të rritur investimet në rrjete të shpejtësisë së lartë nga të gjithë operatorët.

## **1.2. Promovimi i investimeve në infrastrukturën e fibrave optike.**

### **1.2.1. Përditësimi i ATLAS-it me informacion të përmirësuar nga operatorët për infrastrukturën e rrjeteve të tyre si dhe funksionalitetet e tij.**

Me qëllim promovimin e investimeve efikente në infrastrukturën broadband, AKEP ka krijuar një regjistër elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike (një ATLAS bazuar në platformën Eeb GIS), i cili përmban informacion mbi rrjetet publike të komunikimeve, facilitetet e komunikimeve elektronike, kabllot nëntokësore dhe transmetuesit radio).

AKEO gjatë vitit 2018, përfundoi një përmirësim të plotë (full upgrade) të sistemit ATLAS, populloi sistemin me informacion mbi infrastrukturën pasive të operatorëve të telekomunikacioneve dhe zhvilloi dy ndërfaqe: një për operatorët e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe një për publikun e gjerë. Në vitin 2019, AKEP do të vijojë të punojë në përmirësimin e funksionaliteteve dhe aksesit të ATLAS-it.

### **1.2.2. Përfshirja në ATLAS e informacionit për rrjetet e utiliteteve**

Në përputhje me Ligjin 120/2016 dhe legjislacionin sekondar të tij, ATLAS-i do të përditësohet për të përfshirë informacion mbi infrastrukturën pasive të rrjetit të sektorëve të tjerë të industrisë që është i përshtatshëm për vendosjen e rrjeteve të komunikimeve elektronike. Kjo pritet të mbështesë rolin e AKEP-it si një Pikë e Vetme Informacioni (SIP) e hapur për përdorim nga të gjithë palët e interesuara për të marrë informacion të përditësuar mbi infrastrukturën e rrjeteve të komunikimeve elektronike.

### **1.2.3. Ndryshime në Rregulloren Nr.26/2012 për funksionimin e ATLAS-it.**

AKEP gjatë vitit 2019 do të kryesjë rishikim të Rregullores Nr.26/2012, mbi “Përmbajtjen, formën dhe funksionimin e regjistrit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë”, për të mbështetur mbledhjen e informacionit të infrastrukturës e rrjeteve nga sektorë të tjerë të industrisë.

## **1.3. Përshpejtimi i procedurës për caktimin e spektrit të disponueshëm, që është i përshtatshëm për shërbime broadband.**

### **1.3.1. Kryerja e procedurës së tenderit për dhënien e spektrit 800 MHz për shërbimet mobile broadband**

AKEP gjatë vitit 2019 planifikon të kryejë procedurën e tenderit për dhënien e spektrit 800 MHz (DD1) për shërbimet mobile broadband. Procedura fillimisht ishte parashikuar të kryhej në Shtator

2018, por u shty më pas, sipas kërkesave të operatorëve - së pari në Dhjetor 2018 dhe aktualisht në Shkurt 2019.

### **1.3.2. Kryerja e procedurave për rinovimin e autorizimit të Albtelecom për radiofrekuancat në brezat 900/1800 MHz**

Autorizimet e spektrit në brezin 900 MHz dhe 1800 MHz të lëshuara për Albtelecom në vitin 2004 si pjesë e paketës së privatizimit përfundojnë afatin e tyre në vitin 2019. Pas një konsultimi publik me industrinë, AKEP do të përcaktojë dhe zbatojë procedurën e rinovimit dhe kushtet për për këta autorizime.

Legjislacioni aktual nuk parashikon një mundësi për të filluar procedurat për rinovimin e autorizimeve të spektrit para gjashtë muajve të skadimit të tyre. Me qëllim të përmirësimit të qëndrueshmërisë dhe parashikueshmërisë në dhënien dhe rinovimin e të drejtave individuale të përdorimit të spektrit, AKEP do të vlerësojë një mundësi për të ndryshuar dispozitat e legjislacionit Shqiptar mbi procedurat e rinovimit në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e ri të Komunikimeve Elektronike Evropiane të BE-së (EECC).

Për të siguruar transparencën dhe sigurinë juridike për zotëruesit e autorizimeve të spektrit, mundësia e rinovimit duhet të merret në konsideratë brenda një periudhe të përshtatshme kohore përpara skadimit të autorizimeve (p.sh. EECC sugjeron që procedurat e rinovimit duhet të merren në konsideratë apo të fillojnë të paktën dy vjet para skadimit të autorizimeve).

### **1.3.3. Bashkëpunim me MIE dhe AMA për plane dhe masa për vënien në dispozicion për komunikimet elektronike të brezit 700 MHz (DD2)**

AKEP do të bashkëpunojë ngushtë me MIE dhe me Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA) për zhvillimin e propozimeve për përdorimin e ardhshëm të brezit 700 MHz, për t'a vendosur atë në dispozicion për shërbimet e komunikimeve elektronike, duke përfshirë aspektet procedurale lidhur me migrimin e shërbimeve të transmetimeve audiovizive që aktualisht janë të licensuara në këtë brez. AKEP gjatë vitit 2019 do të kryejë dhe një proces këshillimi publik për aspektet e lidhur me përdorimin e ardhshëm të brezit 700 MHz për operatorët e rrjeteve celulare.

### **1.3.4. Bashkëpunim me MIE për plane dhe masa për përdorimin e brezit 1400 MHz për komunikimet elektronike**

Brezi i 1400 MHz aktualisht mbetet i papërdorur në Shqipëri. AKEP do të punojë ngushtë me MIE në zhvillimin e masave teknike dhe planeve për ta bërë këtë brez të disponueshëm për komunikimet elektronike.

#### **1.4. Mbështetje e iniciativave për zhvillimin e broadband në zonat komercialisht jo-tërheqëse.**

##### **1.4.1. Bashkëpunim i vazhdueshëm me MNO-të për investime dhe bashkëinvestime në zonat Vermosh Qendër, Valbona Qendër, Gërmenj, Kepi i Rodonit, Shkopet**

AKEP do të vazhdojë të monitorojë iniciativat e investimeve dhe bashkëinvestimeve të ndërmarra nga MNO-të për përmirësimin e mbulimit me brez të gjerë të lëvizshëm në zonat me dendësi të ulët të popullsisë.

##### **1.4.2. Bashkëpunimi me autoritetet lokale për të lehtësuar procesin e lejeve të ndërtimit**

Gjatë vitit 2018 AKEP ka evidentuar se operatorët e rrjeteve celulare kanë hasur në vështirësi për marrjen e lejeve të nevojshme të ndërtimit nga autoritetet lokale në zonat me dendësi të ulët të popullsisë apo me mbulim të dobët. Vetëm Albtelecom ka raportuar ndërtimin e një kullë BTS të rrjetit celular në Vermosh, e cila tani është në funksion duke i shërbyer zonës dhe vizitorëve të saj. AKEP synon të përmirësojë bashkëpunimin me autoritetet lokale në mënyrë që të lehtësojë procedurat e dhënies së lejeve për ndërtimin e infrastrukturës fikse dhe mobile të brezit të gjerë në këto zona.

#### **1.5. Promovimi i sigurisë së rrjetit dhe informacionit, në përputhje me rregullat e BE-së për sigurinë kibernetike.**

##### **1.5.1. Masa për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike**

Gjatë vitit 2018 AKEP ka monitoruar masat që janë ndërmarrë nga operatorët e rrjeteve për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe për të parandaluar ndërprerjet e shërbimit, sipas përcaktimeve të Rregullores Nr.37 “Për sigurinë dhe integritetin e rrjeteve”.

AKEP ka bashkëpunuar me Agjencinë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike (ALCIRT), në lidhje me identifikimin e kërcënimeve të mundshme kibernetike dhe njoftimin e operatorëve në kohën e duhur për të marrë masa të menjëhershme.

Gjatë vitit 2019, AKEP do të vijojë monitorimin e zbatimit të Rregullores nr.37 dhe bashkëpunimin me ALCIRT, për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve të komunikimeve elektronike.

##### **1.5.2. Udhëzime për operatorët për kërkesat e sigurisë së rrjetit**

AKEP gjatë vitit 2019 do të miratojë udhëzime më të detajuara për operatorët mbi kërkesat e sigurisë bazuar në rekomandimet e ENISA dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

## **Fusha 2: Nxitje e konkurrencës**

### **2.1 Kryerja e analizave të tregut dhe vendosja e masave rregullatore për operatorët me FNT**

#### **2.1.1 Rishikimi i analizës së tregut me shumicë dhe me pakicë celular**

Më 22 Shkurt 2018, AKEP përfundoi analizën e tregut me shumicë për terminimin e thirrjeve në rrjetet individuale të lëvizshme. Të tre MNO-të – Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom - u përcaktuan si sipërmarrës me FNT në këtë treg. Detyrimet rregullatore të vendosura në këtë analizë ishin kryesisht të njëjta me ata të vendosura në vendimet për FNT në vitin 2014, përfshirë detyrimin për mosdiskriminim në lidhje me thirrjet on-net dhe off-net.

Pas një konsultimi publik, AKEP gjithashtu miratoi në Tetor 2018 reduktimin e përshkallëzuar të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetete celulare (MTR) simetrike për të tre MNO-te me FNT për thirrjet kombëtare në periudhën 2018-2020. MTR e synuara për 2018-2019 dhe 2019-2020 janë të bazuara në nivelin benchmark të MTR mesatare të vendeve të BEREC që kanë aplikuar modelin e kostos Pure LRIC deri në 2016 dhe Korrik 2017 respektivisht.

Në Tetor 2018, AKEP përfundoi analizën e tregut me shumicë të akses/origjinimit, tregun me shumicë për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare, dhe tregun me pakicë celular. Pas ankimeve të operatorëve, AKEP më 15 nëntor 2018, vendosi të shfuqizojë vendimet e analizës së tregut që mbulon këto tre tregje të rrjeteve/shërbimeve celulare. Në vitin 2019, AKEP do të kryejë një proces të ri të analizës së dy tregjeve me shumicë dhe tregut me pakicë celular, duke marrë në konsideratë rekomandimet e KE dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Gjatë vitit 2019 AKEP do të kryejë dhe një analizë të shkaqeve që çuan në daljen nga një treg i rregulluar i një operatori celular, duke i kushtuar vëmendje vendimmarrjes së rregullatorit ndër vite.

#### **2.1.2 Analiza e tregjeve me shumicë të aksesit broadband nga rrjete fikse**

AKEP gjatë vitit 2018 përfundoi analizën e tregut me shumicë për terminimin e thirrjeve në rrjetet fikse, duke përcaktuar të gjithë operatorët e rrjeteve publike të telefonisë fikse (80) si sipërmarrës me FNT. Më 1 Tetor 2018, AKEP miratoi reduktimin e përshkallëzuar të tarifave të terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet fikse (FTR) të operatorëve me FNT për periudhën 2018-2020.

Në vitin 2019, AKEP do të kryejë analizën e re të tregjeve me shumicë të aksesit broadband nga rrjete fikse (tregjet 3 dhe 4 të Rekomandimit të vitit 2014 të KE). Analiza e tregut broadband duhet të përfshijë një vlerësim më të detajuar të tregjeve gjeografike nën-kombëtare duke reflektuar ndryshimet në kushtet e konkurrencës sipas segmenteve gjeografike të tregut. Bazuar në

segmentimin e tregut gjeografik, AKEP do të vlerësojë një mundësi për të aplikuar instrumenta rregullatore më të fokusuara dhe proporcionale në zona më pak konkurruese dhe potencialisht të derregullojnë zonat më konkurruese.

## **2.2 Orientimi në kosto i tarifave të operatorëve me FNT**

### **2.2.1 Zhvillimi i modeleve të kostove për rrjetet celulare dhe fikse**

Me mbështetjen e një projekti të konsulencës ndërkombëtare, AKEP do të zhvillojë modele të kostos LRIC për rrjetet mobile dhe fikse, dhe margin-squeeze, rezultatet të cilave do të përdoren për përcaktimin nga AKEP të tarifave me shumicë nën-rregullim të operatorëve me FNT në tregjet celulare dhe fikse, si dhe për vlerësimin e margin-squeeze të tarifave me shumicë në raport me tarifën me pakicë me efekte negative në konkurrencën e ndershme në treg.

### **2.2.2 Bashkëpunim me AKEP për identifikimin e sjelljeve antikonkurruese dhe masa përkatëse për adresimin në kohë të tyre**

AKEP gjatë vitit 2019 do të punojë për identifikim të qarte dhe në kohë të sjelljeve strategjike të operatorëve të Operatorëve me fuqi të ndjeshme në tregjet përkatëse dhe veçanërisht për çmimet pajustificuesherishtë të uletës nën-kosto dhe bashkëpunim me AK për adresimin e këtyre problemeve.

## **2.3 Monitorim/Vlerësim i tregjeve të shërbimeve postare**

### **2.3.1 Analiza e strukturës së tregjeve të shërbimeve postare**

AKEP do të vlerësojë strukturën e tregjeve të shërbimeve postare dhe do të analizojë statusin e shërbimit universal postar të ofruar nga Posta Shqiptare sipas dispozitave ligjore.

## **2.4 Përmirësimi i cilësisë së të dhënave të dorëzuara nga operatorët dhe raporteve të AKEP për statistikat.**

### **2.4.1 Rishikim i formularëve të statistikave**

Gjatë vitit 2019, AKEP synon të rishikojë formularët e raportimit të operatorëve për statistikat me qëllim përshtatjen e tyre sipas ndryshimit të tregut dhe nevojave të AKEP, përfshirë proceset për RLAH si dhe që të lehtësojë proceset e grumbullimit të të dhënave.

### **2.4.2 Bashkëpunim me INSTAT për kryerje anketimi të tregut të komunikimeve elektronike**



Në bashkëpunim me INSTAT AKEP do të kryejë në anketim segmentut të konsumatorëve për përdorimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike për të mbështetur vlerësimin e tij në analizat tregut edhe me të dhëna në anën e kërkesës.

## Shtylla 3: Mbrojtje e konsumatorit

### 3.1 Rishikimi i kuadrit rregullator për mbrojtjen e konsumatorit

Në Mars të vitit 2018, pas procesit të këshillimit publik dhe një sërë diskutimesh me operatorët, AKEP miratoi ndryshimet në rregulloren e portabilitetit të numrit. Ndryshimet hynë në fuqi më 1 Korrik 2018 dhe konsistojnë, në veçanti:

- Afati për realizimin e portimit do të jetë 24 orë nga kërkesa pajtimtarit, ose nga hedhja në sistemin CRDB e kërkesës nga Operatori Marrës, krahasuar me 3 ditë pune që ishte më parë
- Numri Personal i Identifikimit do të jetë kriteri kryesor i identifikimit dhe heqja e gabimeve të mundshme të emrit/mbiemrit si një arsye e vlefshme e refuzimit për një kërkesë portimi;
- Publikimi nga AKEP i raporteve 3-Mujore për portimet.

AKEP gjatë vitit 2018 kreu dhe një upgrade të softëare të CRDB si dhe ndryshime lidhur me krijimin e një statusi 'pezull' në CRDB për ekzekutimin e kërkesave për portim të pajtimtarëve me paspagim. Ky status i ri do të implementohet në sistemet e operatorëve gjatë vitit 2019 sipas përcaktimeve të AKEP.

Prioritetet e mëtejshme specifike për vitin 2019 në lidhje me mbrojtjen e konsumatorit (përdoruesve fundorë) janë si më poshtë:

#### 3.1.1 Rishikimi i Rregullores mbi kushtet e kontratave, zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe aktet e tjera përkatëse për mbrojtjen e konsumatorit/përdoruesit

AKEP do të rishikojë rregulloret e tij mbi termat dhe kushtet e kontratave të pajtimtarëve dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet pajtimtarëve dhe operatorëve, si dhe akte të tjera të lidhura me to.

AKEP synion që pas procesit të vlerësimit të akteve rregullatore përkatëse të mbrojtjes së konsumatorit, të kryejë dhe një konsolidim të tyre në një akt/rregullore të vetme.

#### 3.1.2 Rishikimi i formularëve të regjistrimit të përdoruesve, rregulla specifike për integritetin e të dhënave të përdoruesit dhe verifikimi i tyre nga operatorët

AKEP parashikon masa të mëtejshme në lidhje me mbrojtjen dhe integritetin e të dhënave të konsumatorëve të ruajtura nga operatorët. Operatorëve do të kërkohet që të verifikojnë korrektësinë e të dhënave të përdoruesve në sistemet e tyre. AKEP do të rishikojë formularët e regjistrimit të përdoruesve dhe do të vlerësojë rregullat dhe procedurat për mbrojtjen e integritetit të të dhënave të përdoruesit dhe verifikimin e tyre nga operatorët.

AKEP, në bashkëpunim me Komisionerin e të dhënave personale do të monitorojë garancimin e saktësisë së të dhënave të pajtimtarëve dhe mbrojtjes së tyre nga operatorët.

### **3.1.3 Krijimi i një regjistri “Mos telefononi-Do Not Call ME” për thirrjet e pakërkuara**

AKEP do të punojë në ngritjen e një regjistri “Do Not Call Me”, për të rregulluar aktivitetet e telemarketuesve që bëjnë thirrje telefonike të padëshiruara telefonike për individë privatë. Skema e regjistrimit do të mundësojë përdoruesit që të bëjnë 'opt-out' pra të mos marrin thirrje të pakërkuara nga kompanitë telemarketing. AKEP do të shqyrtojë praktikatat më të mira ndërkombëtare për krijimin dhe funksionimin e një regjistri të tillë.

## **3.2 Përmirësimi i informacionit për konsumatorin**

Gjatë vitit 2019, AKEP planifikon një sërë masash që synojnë të përmirësojnë informacionin e konsumatorit. Kjo përfshin:

### **3.2.1 Përmirësimet në faqen e AKEP-it me fokusin e konsumatorit.**

AKEP në fund të vitit 2018 përfundoi procesin e ri-dezignimit të faqes ëeb të tij, duke vendosur konsumatorin/përdoruesit fundore në fokus të saj. Gjatë vitit 2019, AKEP do të punojë për përmirësimet të metejshme të faqes, formës dhe përmajtjes, sidomos për konsumatorët.

### **3.2.2 Thjeshtimi i afateve dhe kushteve të kontratave të konsumatorëve.**

AKEP do të ndjekë nga afër punën e BEREC mbi modelin standard për kontratat e konsumatorëve për shërbimet e komunikimeve elektronike të parashikuara nga dispozitat e reja të EECC.

### **3.2.3 Krijimi i hartave të mbulimit interaktiv për rrjetet mobile, fikse dhe shërbimet postare të disponueshme në faqen e internetit të AKEP.**

AKEP do të shfrytëzojë praktikatat më të mira ndërkombëtare të rregullatorëve në vendet e BE, për mundësimin në faqen ëeb të tij të hartave interactive për shërbime të rrjetev celulare dhe akses broadband fikse.

## **3.3 Implementimi i marrëveshjeve RLAH me Kosoën dhe vendet e Ballkanit Perëndimor.**

Gjatë vitit 2018, AKEP ka ndërmarrë hapa proaktiv në lehtësimin e heqjes së roamingut me vendet fqinje. Ky proces është zhvilluar në konsultim me aktorët përkatës për vlerësimin e ndikimit të reduktimeve të tarifave për operatorët celularë, dhe janë kryer një sërë aktivitetesh si:

- Takime me MIE, RCC, KE, BEREC, vendet e Ballkanit Perëndimor për marrëveshjet e reja roamingale.

- Takimi i nivelit të lartë me MIE dhe MNO në Korrik duke krijuar një grup pune për roaming.
- Një projektligj i ri u miratua nga Komisioni i Veprimtarive Prodhuese dhe Mjedisit më 6 Dhjetor 2018 dhe pritet të miratohet së shpejti nga parlamenti. Amendamenti i jep të drejtën AKEP për të rregulluar tarifat e roamingut bazuar në marrëveshjet ndërkombëtare reciproke të nënshkruara nga Shqipëria.
- Më 26 Nëntor 2018 nga ministritë e komunikimeve elektronike u nënshkrua marrëveshja Shqipëri-Kosovë për heqjen e roamingut midis dy vendeve. RLAH midis Shqipërisë dhe Kosovës do të fillojë të zhvillohet nga Qershori 2019, bazuar në vendimet e rregullatorëve përkatës.
- Marrëveshja e RLAH në vendet e Ballkanit Perëndimor pritet të nënshkruhet nga ministritë përkatëse në prill-maj 2019.

Për vitin 2019, AKEP planifikon veprimet e mëposhtëme:

### **3.3.1 Bashkëpunimi me ARKEP për implementimin e marrëveshjes RLAH Shqipëri-Kosovë.**

### **3.3.2 Nxjerrja e akteve përkatëse nga AKEP për RLAH me Kosovën**

### **3.3.3 Vijimi i bashkëpunimit me MIE, BEREC, EC për RLAH në ËB**

## **3.4 Monitorimi i mbulimit me rrjet dhe QoS në zonat me dendësi të ulët popullore**

AKEP do të ndërmarrë disa iniciativa me qëllim të përmirësimit të mbulimit të rrjeteve mobile dhe cilësisë së shërbimeve në zonat me dendësi të ulët të popullsisë. Kjo përfshin:

### **3.4.1 Monitorimi i zbatimit nga MNO-të i detyrimeve të mbulimit me rrjet dhe identifikimi i zonave komercialisht jo-atraktive.**

Kjo punë duhet të kryhet në bazë të informacionit nga monitorimet, të hartës së infrastrukturës të mbështetur nga ATLAS-i i infrastrukturës që duhet të ndihmojë në identifikimin e zonave me pak ose pa mbulim me rrjet.

### **3.4.2 Publikimi i të dhënave krahasuese të QoS, duke përfshirë raportet e rregullta të monitorimit.**

Monitorimi i QoS do të kryhet përmes një kompanie të specializuar dhe të pavarur që mbulon të gjithë territorin e Shqipërisë dhe siguron të dhëna të besueshme të krahasimit.

### **3.5 Masa për Net-Neutrality**

#### **3.5.1 Masa për përfshirje në legjislacion të rregullave të BE/BEREC për Net-Neutrality**

AKEP do të fillojë të punojë për zbatimin në legjislacionin Shqiptar të dispozitave të Rregullores së BE-së 2015/2120 (Rregullorja TSM) dhe udhëzimeve të BEREC-it për neutralitetin e rrjetit. Kjo do të përfshijë zbatimin e dispozitave për cilësinë e shërbimit dhe shpejtësinë e internetit në kontratat e konsumatorëve.

#### **3.5.2 Bashkëpunim me BEREC për instrumentin e matjes së Net-Neutrality**

Në bashkëpunim të ngushtë me BEREC, AKEP do të punojë në implementimin e një instrumenti të matjes së shpejtësisë broadband dhe neutralitetit të rrjetit që mund të përdoret për të fuqizuar konsumatorët në mosmarrëveshjet e tyre me ISP-të për shpejtësinë broadband.

### **3.6 Garantimi i dispoeshmërisë SHU postar dhe cilësisë së shërbimeve postare**

#### **3.6.1 Monitorim i vijueshëm i ofrimit të SHU postar dhe shërbimeve të tjera postare**

AKEP gjatë vitit 2019 do të vijojë monitorimin epërmbythës të detyrimeve të ofruesit të SHU postar dhe ofruesive të shërbimeve të tjera postare, përfshirë një analizë të sektorit postar dhe ofrimit të SHU nga Postat Shqiptare dhe mundësisë së ofrimit të SH nga ofrues të tjerë të shërbimit postar.

#### **3.6.2 Bashkëpunim me institucionet kombëtare dhe Posta Shqiptare për saktësimin e adresave dhe implementimin e sistemit të ri të adresave**

Saktësia e adresave është një element shumë i rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve cilësore postare dhe AKEP do të bashkëpunojë me Postën Shqiptare si ofrues i SHU postar dhe institucionet kombëtare për implementimin e sistemit të ri të adresave në shërbimet postare (universal dhe shërbimeve të tjera).

### **3.7 Masa për garantimin e SHU të komunikimeve elektronike**

#### **3.7.1 Përgatitje e kuadrit nen-ligjor për SHU të komunikimeve elektronike**

AKEP gjatë vitit 2019 do të punojë për përgatitjen e kuadrit nen-ligjor për SHU në komunikimet elektronike, duke marrë në konsideratë përcaktimet e Kodit të Komunikimeve elektronike të BE si dhe përvojën e vendeve anëtare në implementimin e tij për SHU.

#### **3.7.2 Fillimi i funksionimit të fondit të SHU, përfshirë mundësinë e përdorimit të tij për zona pilot**

AKEP do të shikojë mundësinë e fillimit të funksionimit të fondit të SHU, përfshirë mundësinë e përdorimit të tij për zona të caktuara/pilot.

## **Shtylla 4: Efienca e brendshme e AKEP dhe bashkëpunimi me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare**

### **4.1. Garantimi i funksionimit ligjor dhe institucional të AKEP.**

#### **4.1.1. Ndjekje e procesit te amendimeve te ligjit 9918 per te siguruar pavarësishtë operative të AKEP**

AKEP gjatë vitit 2018, në bashkëpunim me MIE, ka propozuar ndryshime legislative në Ligjin 9918/2008. Amendimet e propozuara përfshijnë dispozita që sigurojnë pavarësinë financiare dhe kapacitetin institucional të AKEP-it, për të siguruar që të ketë burimet e nevojshme për të kryer detyrat e veta. Në mënyrë që AKEP të jetë në gjendje të mbajë staf të kualifikuar, do të vendoset më shumë fleksibilitet për AKEP për të përcaktuar nivelet e pagave për punonjësit e saj; dhe

#### **4.1.2. Bashkëpunim me MIE për implementimin e EECC në vitet në vijim në legjislacion Shqiptar**

Pas miratimit të fundit të EECC, AKEP do të bashkëpunojë ngushtë me MIE për të mbështetur hartimin e legjislacionit të ri që transponon EECC në ligjin shqiptar.

### **4.2. Përmirësim në forcimin e kapaciteteve dhe efikenses së brendshme të AKEP**

Me vendimin nr. 56/2018, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka miratuar propozimin e AKEP-it për ndryshimin e strukturës organizative të AKEP-it. Struktura e re e AKEP synon krijimin e një organizimi efikas të strukturave të brendshme të institucionit dhe sigurimin e zbatimit të qetë të të gjitha proceseve institucionale të nevojshme për të përmbushur detyrat e AKEP-it që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit në fuqi në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare. Janë parashikuar nisma të mëtejshme për të përmirësuar efikasitetin e brendshëm të AKEP dhe për të lehtësuar transparencën e saj si:

#### **4.2.1. Përdorimi i instrumentave të KE si TAIEX and Twinning Project.**

#### **4.2.2. Konsulencë për In-house Training**

#### **4.2.3. Rishikim dhe konsolidim i rregullreve të AKEP dhe qartësim i detyrave të strukturave të AKEP**

#### **4.2.4. Përgatitje/vlerësim i shpenzimeve të përgjithshme të AKEP (për përdorim të brendshëm) sipas departamenteve/funksioneve kryesore të AKEP (frekuenca, mbikqyrje komunikime elektronike, posta, domain etj.**

### **4.3.Përmirësim i bashkëpunimit me institucionet kombëtare**

Në maj të vitit 2018 AKEP nënshkroi një Memorandum të ri Mirëkuptimit me Autoritetin e Konkurrencës (AK), me qëllim të përforcimit të bashkëpunimit ndërmjet dy autoriteteve, me fokus në ndihmën reciproke dhe shkëmbimin e informacionit, si dhe ndarjen e qartë dhe transparente të detyrave.

AKEP synon të krijojë një marrëveshje të ngjashme bashkëpunimi me Komisionin e Mbrojtjes së Konsumatorit për të thelluar bashkëpunimin me KMK në mënyrë që të adresojë praktikatat e padrejta të mundshme të ofruesve të shërbimeve që veprojnë në sektorin elektronik dhe postar.

### **4.4. Projekti për zbatimin e Qendrës Kombëtare të Radio Frekuencave**

Projekti synon të mbështesë përdorimin optimal të radiofrekuencave nëpërmjet stacioneve fikse të monitorimit në Krujë, Shkodër, Korçë, Vlorë, Fier, Gjirokastrë. Kjo përfshin krijimin e një stacioni të dytë të monitorimit celular (MMS) dhe pajisjen e zyrave rajonale me analizatorë të spektrit RF.



## ANEKS 1: PLANI I VEPRIMIT TË AKEP PËR VITIN 2019

Fushat Kryesore	Prioritetet Strategjike	Veprime Specifike
<p style="text-align: center;"><b>Kushte te favorshme per Investitoret</b></p>	<p><b>1.1</b> Rregulla te qarta dhe te qendrueshme per zhvillimin e infrastruktures broadband.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mbështetje dhe bashkëpunim me MIE në përgatitjen dhe implementimin e legjislacionit sekondar për Ligjin Nr.120/2016</li> <li>2. Masa rregullatore proporcionale për tregjet me shumicë broadband për të mbrojtur dhe promovuar stimujt e investimeve për broadband.</li> </ol>
	<p><b>1.2</b> Nxitja e investimeve ne infrastrukturen me Fiber Optike.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>3. Përditësimi i ATLAS-it me informacion të përmirësuar nga operatorët për infrastrukturën e rrjeteve të tyre si dhe funksionalitetet e tij</li> <li>4. Përfshirja në ATLAS e informacionit për rrjetet e utiliteteve</li> <li>5. Ndryshime në Rregulloren Nr.26/2012 për funksionimin e ATLAS</li> </ol>
	<p><b>1.3</b> Përsheptimi i procedurave per venien ne dispozicion te operatoreve te spektit te pershtatshem per sherbimet broadband</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>6. Kryerja e procedurave për alokimin e spektrit 800 MHz (DD1) për shërbime broadband celulare</li> <li>7. Kryerja e procedurave për rinovimin e autorizimit të Albtelecom për radiofrekuancat në brezat 900/1800 MHz</li> <li>8. Bashkëpunim me MIE dhe AMA për plane dhe masa për vënien në dispozicion për komunikimet elektronike të brezit 700 MHz (DD2), përfshirë kryerjen e një procesi keshilimi publik nga AKEP per brezin 700 MHz.</li> <li>9. Bashkëpunim me MIE për plane dhe masa për përdorimin e brezit 1400 MHz për komunikimet elektronike</li> </ol>
	<p><b>1.4</b> Mbeshtetja e inisiativave per zhvillim broadband ne zonat komercialisht jo-tërheqëse.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>10. Bashkëpunim i vazhdueshëm me MNO-të për investime dhe bashkë-investime në zonat Vermosh Qendër, Valbona Qendër, Gërmenj, Kepi i Rodonit, Shkopet.</li> <li>11. Bashkëpunimi i AKEP me organet e pushtetit lokal për lehtësimin e proceseve të lejeve përkatëse për ndërtim infrastrukture broadband sidomos në zonat e pambuluara me rrjet celular</li> </ol>
	<p><b>1.5</b> Nxitja e sigurisë së rrjeteve dhe informacionit në linjë me rregullat e BE për sigurinë kibernetike</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>12. Monitorim i vazhdueshëm i masave të marra nga operatorët dhe zbatimit të tyre për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve të k.elektronike sipas Rregullores Nr.37 të AKEP.</li> <li>13. Udhëzime të AKEP për operatorët për kërkesat për sigurinë e rrjeteve sipas rekomandimeve të ENISA dhe praktikave më të</li> </ol>

Fushat Kryesore	Prioritetet Strategjike	Veprime Specifike
		mira ndërkombëtare
<b>Nxitje e konkurrencës</b>	<b>2.1</b> Kryerja e analizave të tregut dhe vendosja e masave rregullatore për operatorët me FNT	14. Rishikimi i analizës së tregut për tregjet me shumicë dhe me pakicë celular. 15. Analizë e shkaqeve që çuan në daljen nga një treg i rregulluar i një operatori celular, duke i kushtuar vëmendje vendimmarrjes së rregullatorit ndër vite. 16. Procesi i analizës së tregut broadband nga rrjete fikse duke përfshirë një analizë më të detajuar për segmentim gjeografik të tregjeve përkatës.
	<b>2.2</b> Orientimi në kosto i tarifave të operatorëve me FNT dhe identifikimi në kohe i sjelljeve strategjike antikonkurrese.	17. Zhvillimi i modeleve të kostove për rrjetet celulare dhe fikse 18. Bashkëpunim me AK për sjellje antikonkurrese dhe masa perkatëse
	<b>2.3</b> Monitorim/Vlerësim i tregjeve të shërbimeve postare	19. Analiza e strukturës së tregjeve të shërbimeve postare.
	<b>2.4</b> Përmirësimi i cilësisë së të dhënave të dorëzuara nga operatorët dhe raporteve të AKEP për statistikën	20. Rishikim i formularëve të statistikave 21. Bashkëpunim me INSTAT për kryerje anketimi të tregut të komunikimeve elektronike
<b>Mbrojtje e konsumatorit</b>	<b>3.1</b> Rishikimi i kuadrit rregullator për mbrojtjen e konsumatorit/përdoruesit	22. Rishikimi i Rregullores mbi kushtet e kontratave, zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe aktet e tjera përkatëse për mbrojtjen e konsumatorit/përdoruesit 23. Rishikimi i formularëve të regjistrimit të përdoruesve, 24. Garantimi i saktësisë së të dhënave të pajtimatërvë dhe mbrojtjes së tyre nga operatorët, në bashkëpunim me Komisionerin e të dhënave personale 25. Krijimi i një regjistri “Mos telefononi-Do Not Call ME” për thirrjet e pakërkuara
	<b>3.2</b> Përmirësimi i informacionit për konsumatorin.	26. Përmirësim në faqen e AKEP-it me fokusin e konsumatorit 27. Thjeshtimi i termave dhe kushteve të kontratave të konsumatorëve 28. Krijimi i hartave të mbulimit interaktiv për rrjetet mobile, fikse dhe shërbimet postare të disponueshme në faqen e internetit të AKEP

Fushat Kryesore	Prioritetet Strategjike	Veprime Specifike
	<b>3.3</b> Implementimi i marrëveshjeve RLAH me Kosoësn dhe vendet e Ballkanit Perëndimor	29. Bashkëpunimi me ARKEP për implementimin e marrëveshjes RLAH Shqipëri-Kosovë. 30. Nxjerrja e akteve përkatëse nga AKEP për RLAH me Kosovën 31. Vijimi i bashkëpunimit me MIE, BEREC, EC për RLAH në ËB.
	<b>3.4</b> Monitorimi i mbulimit me rrjet dhe QoS në zonat me dendësi të ulët popullore.	32. Monitorimi i zbatimit nga MNO-të i detyrimeve të mbulimit me rrjet dhe identifikimi i zonavekomercialisht jo-atraktive 33. Publikimi i të dhënave krahasuese të QoS, duke përfshirë raportet e rregullta të monitorimit
	<b>3.5</b> Masa për Net-Neutrality	34. Masa për përfshirje në legjislacion të rregullave të BE/BEREC për Net-Neutrality 35. Bashkëpunim me BEREC për instrumentin e matjes së Net-Neutrality
	<b>3.6</b> Garantimi i disponueshmërisë SHU postar dhe cilësisë së shërbimeve postare	36. Monitorim i vijueshëm i ofrit të SHU postar dhe shërbimeve të tjera postare 37. Bashkëpunim me institucionet kombëtare dhe Posta Shqiptare për saktësimin e adresave dhe implementimin e sistemit të ri të adresave
	<b>3.7</b> Masa për garantimin e SHU të komunikimeve elektronike	38. Përgatitje e kuadrit nen-ligjor për SHU të komunikimeve elektronike 39. Fillimi i funksionimit të fondit të SHU, përfshirë mundësinë e përdorimit të tij për zona pilot
<b>Efikasiteti i brendshëm AKEP dhe bashkëpunim me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare</b>	<b>4.1</b> Garantimi i funksionimit ligjor dhe institucional të AKEP. Vlerësim i nevojës për amendime të legjislacionit.	40. Ndjekje e procesit të amendimeve të ligjit 9918 për të siguruar pavarësinë operacionale të AKEP 41. Bashkëpunim me MIE për implementimin e EECC në vitet në vijim në legjislacion Shqiptar.
	<b>4.2</b> Përmirësim në forcimin e kapaciteteve dhe efikasitetit të brendshëm të AKEP	42. Përdorimi i instrumentave të KE si TAIEEX dhe Twinning Project. 43. Konsulencë për In-house Training 44. Rishikim dhe konsolidim i rregullave të AKEP dhe qartësim i detyrave të strukturore të AKEP 45. Përgatitje/vlerësim i shpenzimeve të përgjithshme të AKEP sipas departamenteve/funksioneve kryesore të AKEP (për përdorim të brendshëm).

Fushat Kryesore	Prioritetet Strategjike	Veprime Specifike
	<b>4.3</b> Bashkëpunim i ngushtë dhe arritje e koherences se plote me rregullatorin ex-post, AK dhe Komisionin e Mbrojtjes së Konsumatorit.	46. Forcim bashkëpunim me AKEP për analizat e tregut dhe adresimin e sjelljeve antikonkurrese 47. Rritje e bashkëpunimit me KMK për adresimin e praktikave pandershme tregtare të operatorëve.
	<b>4.5</b> Projekti për zbatimin e Qendrës Kombëtare të Radio Frekuencave.	48. Krijimi i një stacioni të dytë të monitorimit celular (MMS) 49. Pajisja e zyrave rajonale me analizatorë të spektrit RF.